

## Komuna e Pejës 2017: Problemet kryesore dhe trendet buxhetore

### Hyrje

Komuna e Pejës udhëhiqet nga Gazmend Muhaxheri i cili përfaqëson Lidhjen Demokratike të Kosovës. Ky është mandati i tij i parë.

Në zgjedhjet e fundit për kryetar të komunës (nëntor 2013), Gazmend Muhaxheri ka fituar në balotazh ndaj Ali Berishës nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Ky i fundit në raundin e parë ka siguruar 15,269 vota (apo 36%) ndërsa Muhaxheri ka pasur 17,200 vota (apo 41%). Në balotazh Muhaxheri ka siguruar 23,211 vota (56%).<sup>1</sup>

Hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.<sup>2</sup> Sipas një studimi të UNDP-së, 93% e qytetarëve të Pejës konsiderojnë se komuna mund t'i zgjidhë problemet me të cilat ballafaqohen ata.<sup>3</sup> Dy vite pas nisjes së mandatit të kryetarit Muhaxheri, 70% e qytetarëve janë shprehur të kënaqur me punën e tij, përderisa vetëm 36% e qytetarëve kanë konsideruar se fondet publike në komunë menaxhohen siç duhet.<sup>4</sup>

Në prag të zgjedhjeve lokale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar problemet kryesore të Komunës së Pejës. Ndër problemet më madhore

---

<sup>1</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet për Kryetarë Komune 2013. Burimi: <http://bit.ly/1d30foS> (Hapur më 18 qershor 2017) Rezultatet për Balotazh. Burim: <http://bit.ly/2szzr1OU> (Qasur më 18.06.2017)

<sup>2</sup> Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësisë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU> (Qasur më 18.06.2017)

<sup>3</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

<sup>4</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 91 & 92. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

kishin dalë të jenë: mungesa e objekteve shkollore, veçmas me mungesën e shkollës së mesme të mjekësisë, mungesa e rrjetit të kanalizimit nëpër fshatra, prerja ilegale e pyjeve, mungesa e ujit të pijes, eksploatimi ilegal i zhavorrit, mungesa e qendra shëndetësore në rajonin e bjeshkëve të Rugovës, hedhja e mbeturinave në lumin “Çokalica”, rruga e ngushtë në relacionin Pejë-Tërstenik si dhe mungesa e ndriçimit publik në shumë zona të qytetit.<sup>5</sup>

## **Problemet aktuale të Komunës së Pejës**

### **Mungesa e një shkolle për lagjen “7 Shtatori” në Pejë**

Nxënësit e ciklit të ulët nga klasa e parë deri të nëntën të lagjes “7 shtatori” detyrohen të ecin me kilometra për të vijuar procesin mësimor në shkollën më të afërt atë “Xhemajl Kada” apo “Skënderbeu” në fshatin Vitomericë. Ajo që është më shqetësuese, nxënësit e lagjes “7 shtatori” për të shkuar në drejtimin e këtyre dy shkollave duhet të kalojnë përgjatë rrugës me katër kors, që paraqet rrezik për shkak të lëvizjes së automjeteve me shpejtësi të madhe. Pra është e domosdoshme ndërtimi i një shkolle në këtë lokalitet që t’ju shmanget fëmijëve të kësaj lagjeje ecja mbi 4 kilometra për të shkuar në shkollë. Autoritetet komunale disa herë kanë premtuar që do të gjendet një parcelë për ndërtimin e shkollës fillore në lagjen “7 shtatori”, mirëpo deri me tani nuk ka diçka konkrete.<sup>6</sup>

### **Trajtimi i mbeturinave**

Peja ka problem serioz me menaxhimin e mbeturinave. Trotuaret, hapësirat gjelbëruese dhe zona të ndryshme të qytetit shpesh mbulohen nga mbeturinat, përkundër se ato largohen vazhdimisht nga kompania përgjegjëse. Mirëpo mungesa e kontejnerëve nëpër shumë vende të qytetit dhe mos vendosja e tyre nga institucionet komunale bëjnë që këto hapësira të shfrytëzohen për hedhje të mbeturinave nga banorët. Në anën tjetër as inspektorët komunal nuk i ndëshkojnë personat që ndotin ambientit. Me shqetësues është fakti se si trajtohet menaxhimi i mbeturinave në rajonin e Rugovës. Institucionet komunale nuk veprojnë karshi bizneseve, kompanisë përgjegjëse, dhe qytetarëve që nuk kryejnë obligimet e tyre apo ndotin ambientin e kësaj zone malore që ka shumë vizitore. Kjo situatë po dëmton në masë të madhe edhe imazhin e qytetit të Pejës karshi vizitorëve.

---

<sup>5</sup> Instituti GAP. Problemet Kryesore dhe trendet buxhetore të Komunës së Pejës 2013. Burim: <http://bit.ly/2oTixCX> (Qasur me 18.05.2017)

<sup>6</sup> Problemet nëpër komuna janë listuar bazuar në intervista të drejtpërdrejta me përfaqësues komunal, të partive politike, shoqërisë civile, mediave dhe njohëseve të qeverisjes lokale.

### **Ndërtimet pa leje**

Në vitin 2015 dhe 2016, në raportin vjetor të punës së komunës nga 28 objekte banesore sa janë ndërtuar, 23 nga to kanë pasur tejkalim të lejes së ndërtimit. Kjo është bërë nga neglizhenca e zyrtarëve të komunës dhe për këtë është arrestuar Drejtori i Inspeksionit, Demë Dashi, për të cilin është shpallur aktakuzë.

### **Ekspluatimi ilegal i zhavorrit**

Ky problem ka datuar edhe në listën e problemeve të cekura më 2013. Shtrati i Lumëbardhit në pjesën që përshkon fshatrat e Grykës së Rugovës, në vazhdimësi shfrytëzohet për nxjerrjen e zhavorrit nga shumë kompani të pa licencuara për kryerjen e veprimtarive të tilla. Katër vende të tilla gjenden edhe në grykën e quajtur Brestovik në lumin Shushica. Kjo dukuri besohet të ndikojë në shkatërrimin e shtretërve të lumenjve dhe në mundësinë e daljes së tyre nga shtrati.

### **Prerjet e pyjeve**

Komunat e Dukagjinit në përgjithësi, por në veçanti pyjet e Komunës së Pejës i janë ekspozuar prerjeve të vazhdueshme, kryesisht në mënyrë ilegale. Në disa raste janë prerë edhe pishat e mbjella dekada më herët. Zona më e prekur nga kjo dukuri vlerësohet të jetë rajoni i fshatrave të Rugovës.

## **Fushave që komuna duhet t'u kushtojë vëmendje**

### **Respektimi i planeve rregulluese**

Komuna e Pejës i ka të evidentuara në qendër të saj rreth 20 objekte të cilat janë bërë jashtë planit rregullues. Komuna do të duhej të ushtronte kontroll me të rreptë në sferën e ndërtimeve dhe të pamundësonte ndërtime të cilat çënojnë planin zhvillimor komunal, planin zhvillimor urban dhe planet rregulluese.


### **Menaxhimi me i mirë i hapësirave publike gjatë sezonit të dimrit**

Komuna e Pejës gjatë sezonit të dimrit 2016/17, është karakterizuar me rrugë të pa pastruara nga bora. Madje sheshi i këtij qyteti ka qenë i tëri i mbuluar me akull dhe kjo gjendje ka qenë kështoj për disa javë. Komuna do të duhej t'i kushtonte vëmendje më të madhe pastrimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve gjatë sezonit të dimrit.

## Trendet buxhetore në Komunën e Pejës (2017)

Komuna e Pejës në vitin 2017 ka planifikuar 22.5 milionë euro buxhet.<sup>7</sup> Në këtë buxhet do të barten nga viti 2016 edhe 1.08 milionë euro të tjera nga të hyrat vetanake të pashpenzuara.<sup>8</sup> Krahasuar me buxhetin e planifikuar të vitit 2013<sup>\*9</sup>, kur ishte koha e zgjedhjeve lokale, buxheti i Pejës i këtij viti ka pasur një rritje prej 2.8 milionë euro. Kjo rritje në masë të madhe buron nga rritja e granteve qeveritare.

**Figura nr.1:** Buxheti i Komunës së Pejës 2017



Në buxhetin e vitit 2017 janë ndarë rreth tre milionë euro më shumë për kategorinë e pagave dhe mëditjeve (13.2 milionë euro) se në 2013, ndërsa janë reduktuar shpenzimet për subvencione dhe transfere (300 mijë euro) për rreth 50 mijë euro. Ndikim të madh në rritjen e buxhetit për paga kishte vendimi i Qeverisë së Kosovës i vitit 2014 për rritjen e pagave në sektorin publik për 25%.<sup>10</sup> Sa i përket ndryshimit të numrit të punësuarve, vërehet se Komuna e Pejës ka angazhuar kryesisht punëtorë

<sup>7</sup>Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2vRS8t2> dhe Ligjin Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

<sup>8</sup> Ministria e Financave. Raporti Financiar 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj>, faqe 63 (hapur më 6 shtator 2017).


\* Në këtë vit mjetet e bartura nga të hyrat e pashpenzuara ishin më të ulëta se në 2017 për rreth 300 mijë euro. Shih Raportin vjetor financiar 2012. Ministria e Financave. Burimi: <http://bit.ly/2wKArJf>, faqe 60 (hapur më 6 shtator 2017).

<sup>9</sup> Shih Ligjin Nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

<sup>10</sup> Zyra e Kryeministrit, Vendimet e mbledhjes së 172-të të qeverisë. Burimi: <http://bit.ly/2w6MK0M> (hapur më 6 shtator 2017).

jashtë listës së pagave, pra që paguhen nga kategori tjera buxhetore. Specifikisht në vitin 2016 janë angazhuar 99 punonjës të tillë.<sup>11</sup> Kurse në kategorinë e investimeve kapitale, shuma e planifikuar në vitin 2017 (5.8 milionë euro) është e njëjtë me atë të vitit 2013.

**Figura nr.2:** Trendët buxhetore të Pejës më 2013 dhe 2017




Komuna e Pejës, gjatë vitit 2016, ka pasur të hyra vetanake në vlerë 3.47 milionë euro, ku vërehet një trend rritës në arkëtimin e të hyrave që nga viti 2013.<sup>12</sup> Kategoria e të hyrave që kontribuon më shumë në buxhetin e Pejës mbetet ajo e tatimit në pronë, nga ku janë arkëtuar mbi 1.5 milionë euro. Ndërsa të hyrat nga kategoria e taksave komunale për leje ndërtimi kanë shënuar rënien më të madhe. Nga kjo kategori janë mbledhur rreth 108 mijë euro më pak se në vitin 2015.<sup>13</sup>

<sup>11</sup> Ministria e Financave. Raporti Financiar 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj> (hapur më 6 shtator 2017).

<sup>12</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti për Komunën e Pejës 2016. Burimi: <http://bit.ly/2wlybyi> (hapur më 6 shtator 2017).

<sup>13</sup> Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2016 për Komunën e Pejës. Burimi: <http://bit.ly/1G2fypQ> (hapur më 6 shtator 2017).

**Figura nr.3:** Të hyrat komunale të Pejës, 2013-2016



**Burimi:** Zyra e Auditorit të përgjithshëm

Krahasuar me vitin 2017, sipas vlerësimeve në ligjin për buxhetin 2017<sup>14</sup>, buxheti i Komunës së Pejës pritet të rritet jo më shumë se dy përqind më 2018 (23 milionë euro) dhe katër përqind më 2019 (23.5 milionë euro). Këtë rritje Peja planifikon ta orientojë kryesisht në investime kapitale. Po ashtu vërehet tendencë e ndryshimit të pjesëmarrjes së disa programeve në buxhet, sikurse ulje e buxhetit të programit për shërbimet sociale dhe rezidenciale.

<sup>14</sup> Ligji Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, faqe 251.

## Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP ofron këto rekomandime:

- Komuna duhet të nisë ndërtimin e objektit të ri të një shkolle fillore në lagjen "7 Shtatori".
- Komuna duhet ta shtojë numrin e shportave për hedhjen e mbeturinave në qytet dhe të rrisë numrin e kontejnerëve të mbeturinave në periferi dhe nëpër fshatra.
- Komuna duhet të angazhohet me seriozisht në ndaljen e ndërtimeve pa leje dhe kontrollimin e tejkalimeve të leje ndërtimore nga ana e subjekteve ndërtuese.
- Komuna duhet t'i ndalë individët që nxjerrin në formë ilegale zhavorr nga lumëbardhi.
- Komuna duhet të tregohet edhe më e vendosur në parandalimin e prerjes ilegale të pyjeve.
- Komuna duhet t'i përzgjedh deri në tetor të çdo viti operatorët privat që merren me mirëmbajtjen e rrugëve të komunës gjatë dimrit me qëllim të evitimit të gjendjes që ka mbizotëruar gjatë sezonit 2016/17.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

**Ky projekt mbështetet nga:**



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*